



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

Revista “Syri Ynë”

Botim periodik i Shoqatës së të verbërve të Kosovës

Nr. 17



Funded by
the European Union

Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj reviste është përgjegjësi e vetme e *Shoqatës së të verbërve të Kosovës* dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Qershor 2023

Përmbajtja

<i>Dy fjalë për botimin.....</i>	<i>faqe 3</i>
<i>Intervista e numrit: Luljeta Kabashi, u.d udhëheqëse e Divizionit për gjithëpërfshirje në MASHTI.....</i>	<i>faqe 4</i>
<i>Kronika: Aktivitetet e shoqatës së të verbërve të Kosovës në periudhën janar-qershor 2023.....</i>	<i>faqe 6</i>
<i>Anketime: zërat e personave të verbër për përvojat në vendin e punës.....</i>	<i>faqe 12</i>
<i>Nga Panairi vjetor i teknologjisë informative për të verbër SightCity 2023 në Frankfurt të Gjermanisë.....</i>	<i>faqe 15</i>
<i>Përfaqësimi dhe lobimi për legjislacionin lidhur me statusin e personave të verbër në shoqëri</i>	<i>faqe 17</i>
<i>Ristrukturimi i Shoqatës së të verbërve, kuvendet në degë, risitë dhe ndryshimet... </i>	<i>faqe 18</i>
<i>Sporti dhe përfaqësimi i personave të verbër në aktivitetet vendore e ndërkombëtare... </i>	<i>f19</i>

[Këshilli botues:](#)

Enver Ulaj, Kryeredaktor;

Melihatë Pllana, Bekim Krasniqi Florian Tishuki, përgatitja e artikujve.

Dy fjalë për botimin

Të dashur lexues të revistës “Syri ynë”.

Revista jonë periodike por del edhe më një numër të ri, që një pjesë prej jush i gjen në pushime verore, pushimet nga shkolla apo në angazhimet e stinës së verës. Dëshira e stafit të revistës është të jetë pranë komunitetit me qëllimet që revista i ka prej fillimit të saj dhe traditës që prej disa dekadash e ka krijuar shoqata në përgatitjen e kësaj reviste. Ajo që ne dëshirojmë që komunitetit t’i ofrojmë diçka më shumë për të lexuar, për t’u informuar dhe për të qenë në rrjedhë më arritjet dhe punën që bëhet në Kosovë dhe jashtë saj lidhur me aftësinë e kufizuar dhe personat me dëmtime në të parë. Kjo konsiderojmë të jetë edhe një kontribut një mjet shtesë për ata që janë të interesuar për të lexuar dhe informuar në përgjithësi, që është e mirëseardhur në kohën kur materialet e printuara në shkrimin braj janë të pakta në Kosovë. Përveç materialeve mësimore që kanë qëllim procesin arsimor, kohë pas kohë shtypjes së ndonjë pjesë nga legjislacioni, materiale tjera në braille nuk gjendjen shumë në Kosovë, prandaj këtë e kemi parë si një mundësi për t’i dhënë komunitetin diçka që plotëson nevojat e tij

Grupi që merret me përgatitjen e revistës ka sjellë ndryshme, por gjithnjë duke e ruajtur identitetin që ka revista, mënyrat e raportimit dhe informimit të anëtarësisë dhe mbajtjen e lidhjes mes shoqatës dhe anëtarësisë së saj. Në këtë kuptim revistën e kemi parë jo vetëm si një mjet për informimin, por edhe realizimin e transparencës, një lloj raportimi për punën, arritjet dhe proceset që ndodhin në vazhdimësi. Është një instrument që tek komuniteti dërgon të përmbledhura informatat mbi aktivitetet dhe ngjarjet, në të cilat shumë herë edhe vet kanë qenë pjesë, por që tash marrin një shfaqje të plotë dhe të një pasqyre të gjerë të gjendjes dhe rrjedhave.

Botimi i kësaj reviste kësaj radhë është bërë i mundur falë mbështetjes nga fondet e Bashkimit Evropian përmes organizatës Kosovo 2.0. Ka qenë programi shumë i qëlluar i organizatës Kosovo 2.0 me emrin “Diversifikimi i zërave në gazetari” që ka mundësuar zgjatjen e jetës për revistën edhe një periudhë një vjeçare. Mbi këtë program SHVK është një përfituesit e kësaj thirrje për grante për media, që do të ndihmojë në krijimin e një ambienti divers për gazetarinë në Kosovë, ku revista jonë është vlerësuar si një kontribut.

Lajmi i mirë është se kuadër të këtij programe do publikohen gjashta numra të revistës “Syri Ynë”. Revista do të jetë dymujore dhe përveç variantit të shtypur në braille mund të ofrohet edhe në formën digjitale, por edhe për herë të parë të audio revistës, që do jetë një përvojë e re për stafin dhe për Shoqatën e të verbërve të Kosovës.

Prandaj ne ju drejtohem me kërkesën, që nëse keni ide, sugjerime, nëse keni dëshirë që ju vet të shkruani dhe botoni në këtë revistë na shkruani në email adresën: info@shvkosova.com dhe ne do trajtojmë së bashku të gjithë temat për të cilat ju keni interesim.

Me respekt
Këshilli botues

Intervista e numrit: Luljeta Kabashi, u.d udhëheqëse e Divizionit për gjithëpërfshirje në MASHT.

Ministria e arsimit, shkencës, teknologjisë dhe inovacionit ka kohë që mes institucioneve vlerësohet se ndër ministrinë që po bëjnë më shumë për pavarësimin dhe integrimin e personave të verbër. Kjo është e dukshme edhe në takimet ndëriministore , si psh ato në të cilat është diskutuar për implementimin e detyrimeve që dalin nga Ligji për personat e verbër për sigurimin e mjeteve tiftoteknike dhe tiflo didaktike, edhe në matjet e arritjeve të parapara në kalendarin e aktiviteteve kushtuar personave me aftësi të kufizuara 2022.

Në këtë kuptim edhe angazhimi i Qeverisë dhe buxhetimi që ka ndodhur vitin e kaluar për përgatitjen sintezës vokale në gjuhën shqipe, si një ndihmesë me rëndësi për personat e verbër në Kosovë, është edhe një vazhde e punës së përbashkët që ndër vite është bërë mes shoqatës së të verbërve, MASHTI dhe Zyrës për Qeverisje të mirë pranë kryeministrit.

Së fundi edhe kualifikimi dhe aftësimi i asistentëve për punë me nxënës/fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë, ka sjellë te një lehtësim në sistemin gjithëpërfshirës të edukimit në Kosovë, që është mirëpritur nga të gjithë të punësuarit në këtë sektor. Znj. Luljeta Kabashi, momentalisht është ushtruese e detyrës si udhëheqëse e Divizionit për gjithëpërfshirje në MASHTI. Me këtë rast për revistën tonë kemi zhvilluar një mini bisedë për temat e mësipërme

Pyetje 1: Si është arsimit i personave me aftësi të kufizuara sot në Kosovë? A është arritur ajo që është synuar gati dy dekada më parë kur është filluar me arsimin inkluziv?

Përgjigje: Në dy dekadat janë bërë shumë ndryshime si në politika arsimore, ashtu edhe janë ndryshuar shumë praktika dhe ka shumë më shumë vetëdijesim ose ndryshim kulture për përfshirje dhe gjithëpërfshirje.

Besoj se pritjet kanë qenë më të mëdha dhe ndryshimet nuk janë në raport me to.

Pyetje 2. Sa jeni të kënaqur me në përgjithësi me edukimin e personave të verbër në Kosovë? Çfarë ndodh me ata pas shkollimit dhe i pavarëson shkolla ata për jetë dhe për tregun e punës?

Përgjigje: Mendoj se në arsimimin e personave të verbër ka lëvizje pozitive në këto dy dekada, meqenëse kane lëvizur në arsim gjithëpërfshirës dhe ka mbështetje nga qendra burimore me qenë se kjo mbështetje është e limituar në mungesë të ekipeve mobile më të mëdha.

Pyetje 3: Angazhimi madhor i MASHTI këto dy vjet kanë qenë sinteza vokale në gjuhën shqipe dhe punësimi i asistentëve për nxënës me nevoja të veçanta. Si do vazhdohet deri në fund të vitit me këto dy procese?

Përgjigje: "Sintezë vokale" ka kaluar procesin e hartimit të termave të referencës dhe s' shpejti do të ndodh shpallja ndërkombëtare për pajisjen.

Punësimi i asistentëve është përgjegjësi e komunave dhe aktualisht shume nga to kanë filluar dhe disa kanë përfunduar procesin e shpalljes së konkurseve.

Pyetje 4: Shoqata e të verbër ka kohë që lobon për implementimin e ligjit për personat e verbër në nenin 10, pika 3 që thotë “Pajisjet tiflo-teknike dhe tiflo-didaktike të cilat lehtësojnë integrimin e personave të verbër në shoqëri janë mjete ndihmëse për të cilat obligohet MPMS, MASHT dhe Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Kosovës për sigurimin dhe shpërndarjen e tyre”. A ka progres në këtë pikë dhe kur do sigurohen ato përfundimisht?

Përgjigje: Divizioni i Arsimit të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta në mungesë të buxhetit ka kërkuar nga UNICEF mbështetje lidhur me pajisjet sipas listës që është hartuar në punëtorinë e vitit 2022 dhe presim shpejt që të pajisen nxënësit e verbër me pajisje tiflo-didaktike.

Kronika: Aktivitetet e shoqatës së të verbërve të Kosovës në periudhën janar-qershor 2023

Brenda gjashtë mujorit të parë të vitit 2023 Shoqata e të verbërve ka zhvilluar një aktivitet të ngjeshur për të arritur objektivat e saj dhe në implementim të projekteve dhe obligimeve që ka nga misioni i saj.

Braji është mundësi

05 janar 2023

Me moton “Braji është mundësi dhe jo imagjinatë”, është mbajtur konferencë për shënimin e ditëve të brajit. Gjatë kësaj konference është prezantua një historik i shpikësit francez të shkrimit të brajit, pedagogut Lui Braj (Louis Braille).

Në këtë konferencë ishin të pranishëm zyrtarë të lartë qeveritarë, përfaqësues të institucioneve shkollore, përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe vet personat e verbër.

SHVK në këtë konferencë falënderoi donatorët që kanë kontribuar në materiale të shtypura në shkrimin braj, duke ju ofruar mundësi të verbërve të kenë qasje të barabartë si çdo qytetar tjerët i Republikës së Kosovës. Aktiviteti është mbështetur nga MKRS

Hartimi i termave te referencës për sintezës vokale në gjuhën shqipe

17 janar 2023

Takim konsultativ për hartimin e termave te referencës për sintezës vokale në gjuhën shqipe. Takimi i kryesua nga Mashti nga znj. Luljeta Behluli Kabashi udhëheqëse e Divizionit për Gjithpërfshirje në MASHTI, me bashkëpunëtoren znj. Naime Reçica, zyrtare po ashtu nga kjo ministri, me pjesëmarrës nga ShVK z. Daut Tishuki dhe znj. Melihate Pllana, nga QBMK “Xheladin Deda”, z. Xhavit Kastrati dhe eksperti e nagzhuar në këtë çështje z. Kadri Sylejmani. Takimet do të vazhdojnë deri në finalizimin e termave specifike për krijimin e sintezës vokale në gjuhën shqipe.

Takim me qeverinë për qasjen e personave të evrbër në informacion

23 janar 2023

Kryetari i SHVK-së z. Daut Tishuki, ka zhvilluar një takim pune me sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë së Republikës se Kosovës z. Arben Krasniqi, së bashku me drejtorin e zyrës për qeverisje te mirë z. Habit Hajredini me bashkëpunëtore. Në takim u diskutua për qasjen e personave të verbër në informacion.

Dorëzohet drafti final të termave të referencës për sintezën vokale

02 shkurt 2023

Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka pasur disa takime me ekspertin për hartimin e termave të referencës së sintezës vokale në gjuhën shqipe së bashku me zyrtarët nga MASHTI dhe QBMK Xheladin Deda.

Ndërsa sot eksperti ne zyrat e SHVK-së ka prezantuar draftin final të termave të referencës në prezencën e zyrtarëve te SHVK-se, MASHTI, dhe QBMK Xheladin Deda.

Drafti final do të pranohet nga MASHTI përmes kompanisë fituese për hartimin e termave të referencës për zhvillimin e sintezës vokale

Promovohet libri me krijimet e personave të verbër “Pak dritë”

6 shkurt 2023

Shoqata e të verbërve të Kosovës ka promovuar librin “Pak dritë” nga 13 krijues me 35 krijime letrare në prozë, poezi e tregime të ndryshme nga personat e verbër.

Ne këtë promovim morën pjesë zyrtarë të ndryshëm, persona të verbër dhe media.

RTK ka zhvilluar një intervistë me një nga krijueset në librin “Pak dritë”.

Ky aktivitet u mbështet nga MKRS në kuadër të projektit “Të verbrit, Kultura dhe Trashëgimia në Kosovë”.

Kërkesa e SHVK për ri-shikim të rregullores së komisionit shtetëror mediko social për rivlerësimin e personave të verbër

6 shkurt 2023

Takim me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së MFPT-se, z. Enis Spahiu dhe këshilltarin e tij z. Elmi Fazliu, së bashku me udhëheqësit e organizatave të personave me aftësi të kufizuara, u diskutua për infrastrukturën ligjore të personave me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu një nga diskutimet ishte edhe kërkesa jone për ri-shikim të rregullores së komisionit shtetëror mediko social për rivlerësimin e personave të verbër të kategorisë së parë, ku z. Spahiu, tha se do të bëhet rishikimi i rregullores në fjalë, për të mos pasur psaur nevojë për rivlerësim të kategorisë së parë tek personat e verbër.

Takimet në këtë përbërje do të jenë mujore dhe SHVK në secilin takim do të japë komente dhe sugjerimet e saj në për pavarësim sa më të plotë dhe integrues për personat e verbër.

Ministria e Financave hap UNIREF-in për grumbullimin e fondeve nga dënimet shqiptuar nga inspektorati për bizneset që nuk plotësojnë kuotën 1 në 50 në punësimin e PAK

23 shkurt 2023

SHVK ka ofruar informata dhe ka sensibilizuar lidhur me thirrjen nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve drejtuar qytetarëve lidhur me zbatimin e ligjit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Bazuar në Ligjin për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara punëdhënësit obligohen që për çdo 50 të punësuar, të punësojnë së paku 1 person me aftësi të kufizuara.

Punëdhënësit nga sektori publik, privat dhe organizatat jo-qeveritare të cilët nuk e përmbushin obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara obligohen që për nxitjen e punësimit të kësaj kategorie, të paguajnë kontribute mujore në lartësi të shumës së pagës minimale.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në linjë me programin e Qeverisë, mbetet e përkushtuar për të krijuar qasje të barabartë në tregun e punës për të gjitha kategoritë shoqërore. Kontributet mujore paguhet në llogarinë e veçantë në Thesar.

Emri i llogarisë bankare: MFTP-Mirëqenia Sociale

Numri I llogarisë bankare:1000400070006532
Iban: XK051000400070006532
Banka: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Vendi: Prishtinë, Kosovë
UNIREFI: MMD881111111111D

Bashkëbisedim me të verbrit lidhur me tregun e punës në Kosovë

27 shkurt 2023

Në kuadër të projektit “Të verbrit dhe tregu i punës në Kosovë” i cili implementohet nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe i financuar nga Fondet e Bashkimit Evropian përmes ATRC dhe BIRN Kosova është mbajtur trajnimi i parë me të punësuarit e verbër. Aty janë diskutuar vështirësitë që kanë personat e verbër në punë, ata dhe familjet e tyre. Është diskutuar edhe drafri i hulumtimit të kryer për personat e verbër dhe vendi i përunës në Kosovë.

Mbështetje e vazhdueshme e SHVK nga KCSF-ja

01 mars 2023

Në kuadër të bashkëpunimit të rëndësishëm që ka SHVK me një nga donatorët mbështetës me të qëndrueshëm të saj, KCSF, është mbajtur një takim me znj. Trina Binaku, përfaqësuese e KCSF, e cila ka vizituar SHVK-në dhe është diskutuar lidhur me sfidat në implementimin e projekteve. SHVK është përfituese dhe ka në implementim projektin në kuadër të grandit institucional, i cili është mbështetur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) “EJA Kosovë”, e bashkë financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Gratë e verbra dhe edukimi mbi riprodhimin dhe shëndetin seksual

08 mars 2023

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, Shoqata e të Verbërve të Kosovës (ShVK), në bashkëpunim me KCSF kanë organizuar një bashkëbisedim me gratë e vajzat e verbra dhe me të parë të dëmtuar si pjesë e edukimit mbi riprodhimin dhe shëndetin seksual të grave.

Gjatë këtij diskutimi, pjesë e së cilit ishin edhe profesionistë shëndetësorë, ndër të tjera u shtjelluan çështje që lidhen me parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e problemeve shëndetësore me qëllim të vetëdijesimit dhe ofrimit të njohurive shtesë për parandalimin e sëmundjeve dhe mbrojtjen e shëndetit.

Kjo ngjarje tematike është pjesë e një seri ngjarjesh që organizohen në kuadër të programit EJA Kosovë në bashkëpunim të ngushtë me partnerët zbatues, ku trajtohen tema të ndryshme me interes shoqëror.

ShVK përkrahet përmes programit EJA Kosovë, program ky i KCSF-së për përkrahje të shoqërisë civile që bashkë-financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Suedia.

Të verbrit dhe tregu i punës në Kosovë

31 mars 2023

Në kuadër të projektit “Të verbërit dhe tregu i punës në Kosovë” u mbajt punëtorja e dytë me të punësuarit e verbër, i cili implementohet nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes ATRC dhe BIRN Kosova. Pas takimit të mbajtur më parë në Pejë, ishte një tjetër takim në Prishtinë dhe mundësi për të diskutuar çështjet e ngritura nga komuniteti në punësim, në vendin e punës, rrugën punë-shtëpi dhe në ngarkesat individuale dhe familjare për transportin, pajisjet e punës dhe akomodimin në vendime punës.

Ekspozita “Përpara” dhe personat e verbër

17 mars 2023

Ngjarja tematike e radhës e programit EJA u organizua përmes vizitës së Shoqatës së të Verbërve të Kosovës (ShVK) në ekspozitën “Përpara” të Fondacionit Shtatëmbëdhjetë. Kjo ekspozitë, e qasshme në formatin audio, është zhvilluar në kuadër të programit “Scanning the region”, që përbën një seri të ekspozitave të ideuara, konceptuara dhe realizuara nën këtë temë, përmes së cilave Fondacioni Shtatëmbëdhjetë përpiket të analizojë çështje shoqërore në rajon.

Kjo ngjarje tematike është pjesë e një seri ngjarjesh që organizohen në kuadër të programit EJA Kosovë, që për qëllim kanë krijimin e bashkëpunimit midis partnerëve zbatues të programit EJA dhe ku njëkohësisht trajtohen tema të ndryshme me interes shoqëror.

ShVK dhe Fondacioni Shtatëmbëdhjetë përkrahen përmes programit EJA Kosovë, program ky i KCSF-së për përkrahje të shoqërisë civile që bashkë-financohet nga Agjencia Zvicërore për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Suedia.

Vizitë monumentet e trashëgimisë kulturore në Gjakovë dhe Pejë

25 mars 2023

Në kuadër të projektit “Të verbërit, kultura, dhe trashëgimia në Kosovë”, i mbështetur nga MKRS, janë vizituar Monumentet e Trashëgimisë Kulturore në Gjakovë dhe Pejë.

Është vizituar mulliri i Haxhi Zekës dhe në Gjakovë janë vizituar “Hani I Haraçisë”, Xhamia e Hadumit” “Teqeja e Sheikh Eminit” pazari i vjetër dhe Çarshia e vjetër. Qëllimi është që personat e verbër të njihen me trashëgiminë e ruajtur në Kosovë dhe të bëhen pjesë e njohjes dhe ruajtjes së kësaj trashëgimie

Punëtori me inspektorët e punës në shtatë regjione të Kosovës

27 mars 2023

Në kuadër të projektit “Të verbërit dhe tregu i punës në Kosovë” janë mbajtur punëtori me inspektorët e punës në shtatë regjione të Kosovës: Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë dhe Pejë. Në këto aktivitete është folur për implementimin e legjislacionit kosovar lidhur me punësimin e personave të verbër, në radhë të parë Ligjit për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, përkatësisht nenit ku thuhet punësimi një personi në çdo 50 të punësuar. Takimet e mbajtura në këto rajone janë mbajtur duke adresuar ftesat edhe zyrtarëve të Qendrave të aftësimeve profesionale, Zyrave të punësimit, etj me qëllim të koordinimit të akterëve dhe nxitjes së punësimit duke u bazuar në infrastrukturën ligjore, që garanton punësimin e PAK. Është analizuar angazhimi i inspektorëve në zbatimin e masave që parasheh ligji, përkatësisht informimi me UNIREFin e sapo hapur nga qeveria për të adresuar

gjobat që shqiptohen ndaj bizneseve që nuk e zbatojnë këtë ligj, që ka qenë një nga kërkesat e kahershme lidhur me këtë çështje.

Projekti implementimet nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës dhe i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë përmes ATRC dhe BIRN Kosova.

Shkrimi braj është një nevojë elementare e komunitetit

11 maj 2023

SHVK ka marrë pjesë në eventin e organizuar nga UNMIK-u me temën: Trustbuilding in Kosova Supporting-Togetherness for a Better Future (Ndërtimi i besimit në Kosovë Mbështetja e Bashkësisë për një të ardhme më të mirë).

SHVK ka prezantuar pajisjet e personave të verbër si makinë brailli, kamera llupa, shkopin e bardhë, pajisjet për lojërat e ndryshme të qasshme për të verbër etj. Gjatë qëndrimit në këtë event, stafi i SHVK-se ka demonstruar aty për aty për shkrimin braj të gjithë të interesuarit, për t'i informuar dhe vetëdijësuar ata në këtë nevojë elementare të komunitetit.

Konferenca për “Ditën Ndërkombëtare të Qasshmërisë”

18 maj 2023

Konferenca për “Ditën Ndërkombëtare të Qasshmërisë” e cila u organizua nga SHPIK dhe Shoqata e të Verbërve të Kosovës. Konferenca u fokusua në prezantimin e barometrit të qasshmërisë, i cili për herë të parë në vendin tonë e bëri vlerësimin e faqeve të internetit të institucioneve publike lidhur me përmbushjen e standardeve ndërkombëtare:

- Web Accessibility Directive (2016/2102/EU),
- European Accessibility Act (EAA) dhe
- United Nations Convention on the Rights of Persons with Disabilities (UNCRPD).

Përmbushja e këtyre standardeve është esenciale për personat me aftësi të kufizuara, e në veçanti të personave të verbër, ishte konkluzioni kryesor i konferencës dhe doli si një nga rekomandimet e saj.

Zgjerohet këndi për lexim për personat me dëmtime në shikim

25 maj 2023

Në kuadër të kabinetit për personat me të verbër në Kosovë u zgjerua këndi për lexim për personat të cilët kanë dëmtime në shikim. Në këtë përurim mori pjesë Bekim Krasniqi, menaxheri i programeve në SHVK, dhe falënderoi kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës z. Burim Berisha dhe drejtorin e Bibliotekën Kombëtare e Kosovë Pjetër Bogdani, z. Fazli Gajraku.

Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas si një mundësi për të ndihmuar komunitetin

6 Qershor 2023

Në zyrat e SHVK pati një takim në të cilën u mirëprit znj. Flutura Berbati Zena, ushtrues detyre e drejtoreshës të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas me bashkëpunëtorë, të cilat dhuruan në shkrimin braj broshurat informuese për shërbimet falas juridike, që ofron ky Agjencion.

Broshurat janë në tri gjuhë dhe do të shpërndahen në degët e SHVK-së. Agjencisë për Ndihmë

Juridike Falas shprehu interesimin për të ndihmuar komunitetin me shërbimet që ofron ajo, për çka duhet dhe një informim më i mirë.

Pjesëmarrja në Komitetin Ballkanik të të verbërve

9 qershor 2023

Delegacioni nga SHVK me ftesë nga Komiteti Ballkanik i të verbërve ka marrë pjesë në takimin apo mbledhjen e radhës, e cila është mbajtur në Drynovo të Bullgarisë

Pjesëmarrës ishin Daut Tishuki- kryetar dhe Bekim Krasniqi menaxher i programeve. Në këtë mbledhje z. Tishuki, ka prezantuar të arriturat e SHVK gjatë punës një vjeçare dhe gjithashtu ka prezantuar sfidat apo nevojat që ka komuniteti i të verbërve në Kosovë.

Gjatë qëndrimit 3 ditor në Bullgari janë krijuar edhe kontakte të reja me përfaqësuesit e shoqatave që përfaqësojnë personat e verbër. Gjithashtu është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit për aplikim në projekte të përbashkëta.

Anketime: zërat e personave të verbër për përvojat në vendin e punës

Viti 2023 ka qenë ndër vitet kur më së shumti është diskutuar lidhur me punësimin e personave të verbër në Kosovë. Angazhimi që vjen pas mobilizimit të madh që ka pasur Shoqata e të verbërve të Kosovës dhe vitit 2022 kushtuar personave me aftësi të kufizuara shpallur nga Qeveria e republikës së Kosovës, është reflektuar me rritjen e numrit të të punësuarve të verbër në Kosovë.

Procesi i punësimit të personave të verbër është një sfidë ne vete për gjithë shoqërinë, për vetë personat e verbër në radhë të parë, për punëdhënësit, për të punësuarit që ndajnë përgjegjësitë e punës me personat e verbër dhe për familjet e personave të verbër. Dilemat në mesin e të punësuarve janë lidhur me atë nëse mund ta përballojnë vendin e punës, ngarkesat që ka ai, nëse mund të dëshmojnë së janë të aftë dhe nëse do të arrijnë ta plotësojnë pritjet që të tjerët kanë ndaj tyre.

“Secili i verbër që punon kontribuon për t’u bere shembull dhe kjo është një përgjegjësi shtesë për mua, sepse mendoj jo veç për vete, por edhe për të tjerë si unë që kërkojnë punë dhe punëdhënësit mund të kenë dyshime e dilema” thotë Gani Gashi, një nga personat e intervistuar në hulumtimin e Shoqatës së të verbërve lidhur me përvojat në vendin e punës nga personat e verbër. Ky deklaram paraqet edhe një nga shqetësimet e vërteta të personave të verbër të punësuar, pasi ndjehen të përgjegjshëm në synimin për të dëshmuar se edhe personat e verbër janë të aftë në punë dhe japin kontributin e tyre në të gjitha sferat e shoqërisë.

Hulumtimi (gjetjet e të cilit do të prezantohen në numrin e ardhshëm të revistës) ka ofruar një pasqyrë mbi gjendjen në punë, pritjet dhe shqetësimet që kanë personat e verbër.

Leutim Gërvalla një in ri që studion dhe merret me muzikë thotë se personave të verbër duhet t’u sigurohen kushte dhe t’ jepen mundësi, jo vetëm për punësim, por për shumë çka tjetër.

“Të verbrit duhet të jenë të barabartë si të gjithë të tjerët, të mos të ndihen të diskriminuar as në punë, shoqëri, shkolla, universitete, e shumë fusha tjera. Ndoshta vështirësitë vijnë nga mungesa e mjeteve dhe kushteve për punë. Lumnije Berisha punon në RTK dhe ka pasur vetë vështirësi për sigurimin e mjeteve për punë, dhe kam pasur një aksion që ka rezultuar me dhurimin e një bray display që i mundëson asaj të shkruajë dhe lexojë në kompjuter, por që ka pasur një kosto prej disa mija euro. “Personave të verbër dhe atyre me dëmtim në shikim, përveç se ju duhet sigurimi i punës duhet t’u sigurohen edhe kushtet e punës në mënyrë që të jenë efikas dhe të konsiderohen të barabartë me kolegët e tyre”, Lumnija.

Edhe mësimdhënësja Asime Pajaziti thekson se është me rëndësi që personat e verbër të pranohen në punë ashtu siç janë. “Shoqëria të vetëdijesohet dhe të jetë e aftë të kuptojë se edhe personat e verbër janë të dobishëm dhe mund te kontribuojnë në shoqëri” shprehet ajo.

Të tjerë të punësuar kanë pasur më pak vështirësi. Kjo varetë dhe nga profesioni, përkatësisht nëse duhet përdorur apo jo teknologjia informative. Hazbie Sylaj punon në Spitalin e Gjilanit dhe është fizioterapiste. “Nuk kemi vështirësi aspak, jemi te kënaqur” thotë ajo.

Edhe kolegu i saj nga i njëjti rajon ka të njëtin profesion. Feim Xhelili është vetëpunësuar poashtu si fizioterapist. “Vetë angazhohen, punoj” thotë Xhelili.

Mendimi pozitiv për veten edhe për aftësitë e veta mund të jetë shumë i rëndësishëm gjatë kërkimit të punës dhe procesit të punësimit. Personat që bartin këtë energji pozitive janë më të pranuar dhe mundësitë e kanë më të shumta. “Me qenë personi vet pozitiv, pastaj te tjerët përshtaten me ty” thotë në anketim Hate Kerleshi. Ajo është studente, por njëkohësisht ka pasur disa angazhime pune gjatë viteve të kaluara. Së fundmi edhe angazhimin në festivalin e këngës të mbajtur në Suharekë.

Edhe Dhurata Kallaba ka po këtë qasje pozitiviste duke potencuar se edhe vetë personat e papunë dhe personat e verbër duhet të bëjnë përpjekje, të mos dëshpërohen dhe të kërkojnë gjithnjë më shumë.

“Sa herë mendoj për punën mendoj se duhet të punohet. Unë nuk kam pasur asnjë problem asnjë ditë. Veç me pas personi vullnet për punë, mos të dorëzohet dhe mos të thotë se nuk mundem me e kry. Me provu dhe me fillu. Të gjitha bëhen” thotë Dhurata Kallaba.

Shqipron Kuliqi ka studiuar gazetari. Është person me angazhime, ka punuar edhe në lëmin e gazetarisë dhe i përfshirë shumë në fushën e sportit. Edhe ai i jep rëndësi përshtatjes me mjedisin, personat tjerë dhe me vendin e punës.

“Disa persona me shikim të dobësuar kanë vështirësi në lëvizje, disa të tjerë në procesin e punës, por unë nuk i kam pasur këto vështirësi, sepse më ka rastisur të dal shumë dhe jam lehtë i ambientueshëm. Çdo person me shikim të dobësuar duhet të kërkojë t'i plotësohen kushtet që ai ta kryejë punën e tij me përpikëri. Unë nuk kisha nevojë për pajisje shtesë, sepse ne çdo kompjuter apo laptop gjendet opsioni për zmadhimin e shkronjave” thotë përvojën e tij të punës Shqipëroni. Megjithëse përvojat nga një punëdhënësi tek tjetri janë të ndryshme, Shqiproni tregon anën e mirë të përvojës së tij të punës, kryesisht në gazetarinë lokale në një portal informativ në komunën e tij.

“Punëdhënësi im gjithmonë ka qenë i gatshëm të m'i plotësonte nevojat dhe kërkesat e mia, por unë personalisht nuk kam pasur nevojë. Kjo punë është një eksperiencë e veçantë për mua, sepse u prita shumë mirë nga stafi i këtij portali, por dhe unë mendoj që nuk lë shumë hapësirë për paragjykitime, sepse atë punë që e marr përsipër e bëj me ndershmëri. Vështirë për kolegët e punës ishte në fillim kur më shihnin që unë i afrohesha me afër ekranit të kompjuterit për t'i kryer punët e mia, por iu thosha se ndoshta tash ju vjen pak e pazakontë (sepse s'kanë parë në përditshmëri kështu), por shpejt mësoheni, dhe ashtu ndodhi. Personat me aftësi të kufizuara duhet të përmirësojnë komunikimin; qasjen, dhe të kenë sa më shumë njohuri në fusha të ndryshme në mënyrë që të dinë të flasin me këdo dhe për shumë tema e të inkuadrohen në punë, socializim si çdo njeri tjetër” thotë Shqiproni.

Por si të vihet deri te vendi i punës? Përparim Lubishtani thotë se kjo është vështirësia më e madhe. “Më e vështira është gjetja e vendit të punës. Edhe pse me ligj parashihet që në 50 punëtorë i 51-i të jetë person me nevoja të veçanta. Rekomandimi im është që të bëhet një hulumtim nëpër të gjitha institucionet e Kosovës se a është duke u zbatuar ligji për punësimin e personave të aftësi të kufizuara, në veçanti a i plotësojnë kushtet për t'i punësuar” thotë Lubishtani.

Qeveria e Kosovës vitin e kaluar e ka kërkuar një raport të tillë nga komunat dhe ministrinë dhe një informatë e tillë është duke u përpunuar. Sugjerimi nga Qeveria ka qenë që aty ku ka mundësi të rishikohen dhe të bëhen sistematizime në vendet e punës, për të hapur hapësira për personat me aftësi të kufizuara aty kudo ku është më e realizueshme. Një rast i tillë po të

realizohet në komuna dhe nëpër ministri do të zgjidhte shumë nga problemet e punësimit të personave më aftësi të kufizuara në Kosovë.

Kjo do të zgjidhte shumë nga problemet që kanë personat e verbër jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe specializimin, respektin dhe vet respektin dhe në total, gjithë kualitetin e jetës së tyre.

“Është mirë të punësohen, të japim kontribut, të jemi të barabartë, dhe të ngrisin vetëdijen e njerëzve dhe integritetin social të personave të verbër është i domosdoshëm pavarësisht se sa paguhen apo vlerën, sepse e ndiejnë veten mirë, është obligim dhe e kalon kohën, rutinën dhe aspektin social e rregullon. Kështu largon edhe nervozën që e kanë personat e mbyllur” thotë Yllka Berisha.

Ndërsa ata që e kanë këtë mundësi dhe këtë shans, ndjehen të kënaqur për mundësinë e dhënë dhe janë falënderues për këtë. “Ndihem i lumtur që punoj dhe falënderoj punëdhënësin tim për sjellje të mirë” shprehet Lumni Tershana.

Punësimi i personave të verbër është duke ndodhur pak nga pak. Ndryshimet duken të mëdha, por ato ende nuk i plotësojnë pritjet dhe kërkesat që ka komuniteti. Angazhimi i shtuar i të gjithëve duhet të jetë që kjo të ndodhë së më shumë duke ua krijuar dhe mundësitë që të shndërrohet në kontribuues për familjen dhe shoqërinë kudo që personat e verbër jetojnë dhe mund të kontribuojnë.

Nga Panairi vjetor i teknologjisë informative për të verbër SightCity 2023 në Frankfurt të Gjermanisë

Këtë vit është mbajtur pqërsëri Panairin vjetor i teknologjisë informative për të verbër SightCity 2023 në Frankfurt të Gjermanisë, që është panairi më i madh i TI për personat e verbër në botë dhe mbledh mbi 100 pjesëmarrës nga e gjithë bota. Panairi kthehej me organizimet pas 3 vjet paузë të shkaktuar nga pandemia botërore e Covid 19, dy vjet pa u mbajtur, kurse vitin e kaluar është mbajtur vetëm online. Në SHVK dhe Qendrës Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda” nga Peja, kanë marrë pjesë Daut Tishuki, Bekim Krasniqi, Anton Prekaj dhe Enver Ulaj

Panairi është mbajtur në datat 10-12.05.2023 në Frankfurt. Delegacioni nga Kosova ka marrë pjesë në ceremoninë fillestare të hapjes ku kanë qenë të pranishme mbi 102 kompani që prodhojnë pajisje nga më të ndryshme të TI-së apo që ofrojnë shërbime për personat e verbër. Gjatë tri ditëve të panairit kemi zhvilluar biseda, dhe jemi prezantuar më një numër të madh të prodhuesve të TI-së, duke mbajtur kontakte dhe bashkëpunime të mëhershme që ka Kosova përmes QBMK dhe Shoqatës së të verbërve të Kosovë, por edhe duke krijuar mjaft njohje dhe bashkëpunime të reja.

Kemi vizituar shtandet dhe kemi takuar bashkëpunëtorët tonë nga e kaluara, ku përfshihen kompanitë me të njohura HelpTech, Brailletec, Envision, Index Braille, etj.

Pas tri vjetësh mos pjesëmarrje, panairi ka ofruar mjaft risi në fushën e zhvillimit të teknologjisë informative. Fokusi jonë ka qenë tek pajisjet që lehtësojnë mësimin për fëmijët e verbër dhe me dëmtime në të parë, orientimin dhe mobilitetin shkathësitë për jetë, etj. Përveç kompanive të paracaktuara për vizitë, ne kemi marrë pjesë edhe ne disa prezantime që kanë ngjallur interes dhe në forumet që zhvillohen në kuadër të panairit, si dhe në takime individuale me ekspozuesit.

Vlen të përmenden: Pjesëmarrja në prezantimet e kompanisë Helptech, në radhë të parë modeli i tyre i tasturës dyshe (në braille dhe me tasturë) Activator; Vendosija e bashkëpunimit me kompaninë italiane JKJ Srl për prodhimin e shenjzimit horizontal (rrugor dhe në ambientet e brendshme) me të cilët kemi paracaktuar një takim në Tiranë pasi ata për Shoqatën e të verbërve të Shqipërisë janë duke krijuar manualin/ standardin për shenjzim publik dhe ne kemi biseduar mundësinë që Kosova mund të përfshihet në të njëjtin, pasi nuk ka nevojë të krijohet një shenjzim i veçantë që ka një kosto në vet; Vendosija e bashkëpunimit me kompaninë turke Beyid, me të cilët ka interes për blerjen e shkopit të bardhë dhe letrës së brajit me çmime më të mira, si dhe çështje tjera të bashkëpunimit me ë verbrit në këtë shtet; Vazhdimi i bashkëpunimit me Brailletec për ofertat e tyre për makina shkrimi braji, etj

Kemi marrë prezantimet dhe ofertat nga Brunomaster për programin e readerit Bruno dhe softuar Brunomaster i prezantuar edhe si një ndihmesë për fëmijët me disleksi dhe me vështirësi në lexim, të cilët na kanë ofruar një qasje trial version dy javor prove, nga kompania AccesSolution për pajisjen zmadhuese OrCam Read; modelet e punës taktike, kombinuar me ngjyra nga

ViewPlus, pajisje të imëta për mësimin e braille nga projekti Taptillo nga OHFA si dhe ofertat e mjeteve shkollore për mësim nga Thinkable. Mes shumë prezantimeve tjera, këto i kemi parë si me interes për mundësi bashkëpunimi dhe blerjes apo shfrytëzimit të pajisjeve të tyre.

Për QBMK Xheladin Deda dhe për komunitetin e personave të verbër kemi identifikuar disa pajisje të nevojshme dhe prodhuesit e tyre, në mënyrë që ato të mbesin në këtë raport si pika në të cilat do të përqendrohemi kurdo që kemi nevojë në të ardhmen për furnizim me pajisje të teknologjisë informative.

Përfaqësimi dhe lobimi për legjislacionin lidhur me statusin e personave të verbër në shoqëri

Ndryshimi dhe plotësimi i legjislacionit, zbatimi i ligjeve ekzistuese dhe hartimi i ligjeve të reja është një angazhim i përhershëm i Shoqatës së të verbërve të Kosovës. Si një aktor aktiv në këtë fushë SHVK në grupet përkatëse, takime formale dhe joformale, aktivitete të përbashkëta dhe për edhe në aktivitete ballë për ballë vendimmarrësve, ka ngritur zërin dhe angazhuar në të mirë të komunitetit.

Një nga angazhimet afatgjatë ka për qëllim krijimin e “një ligji gjithpërfshirës” për aftësinë e kufizuar në Kosovë, dhe kjo ka marrë një angazhim të vazhdueshëm të shoqatës. Janë mbajtur disa takime me përfaqësuesit e OPAK dhe me zyrtarë të lartë qeveritarë për ligjin, për të diskutuar rreth ngecjes që ka çuar në shtyrje dhe mos dërgim të ligjit në Kuvend për miratim. Në shumicën e këtyre takimeve, SHVK ka dhënë kontributin e saj, mirëpo gjithmonë duke pas parasysh të drejtat dhe interesin e personave të verbër të garantuar me ligjin ekzistues për personat e verbër.

Sidoqoftë ligji ende nuk është përfunduar së draftuari, pasi ka pasur kthim në pikën fillestare dhe e ardhja e tij është e paqartë në procesin ekzistues. SHVK megjithatë vazhdon të angazhohet që deri atëherë të punohet më shumë në implementimin e Ligjit ekzistues për personat e verbër, pasi po të zbatohet i plotë ai paraqet një bazë të mirë për mbrojtjen e personave të verbër dhe krijon parakushte për integrimin e tyre në shoqëri.

Në aktivitete tjera për avokim dhe lobim, është lidhur me Ligjin për personat e verbër, nenit 10, pika 3 i cili obligon ministritë për sigurimin e pajisjeve tiflo teknike dhe tiflo didaktike për personat e verbër. Procesi i dialogut me qeverinë, përmes tri ministrive, Arsimit, Shëndetësisë dhe Punës i filluar në katër vjetët e fundit me gjithë progresin e shënuar, ende nuk ka nxjerrë ndonjë rezultat. SHVK është angazhuar edhe më tej në këtë çështje dhe deri me tani janë bërë kërkesa, ankesa, por edhe lobim te deputetët. Deri më tani përveç MASHTI-t, i cili ka filluar të lëviz diçka, të tjerat ministri ende nuk kanë ndonjë ndryshim.

Një nismë e cila ka rezultuar me suksese është se janë hartuar termat e referencë për zhvillimin e sintezës vokale, duke krijuar mundësi për hapjen e tenderimit për fituesin e kompanisë e cila do të zhvillojë sintezën vokale në gjuhën shqipe. Ky ishte një nga obligimet madhore që kanë marrë Qeveria e Kosovës, SHVK dhe institucionet tjera gjatë vitit 2022, vit kushtuar personave me aftësi të kufizuara. Procesi është në rrugë që gjatë vitit 2023 të çojë në adresimin e plotë të këtij problemi.

Ndërsa, për lirim nga tatimi në pronë për personat e verbër, në takimet dhe koordinimin me institucionet, është mundësuar zbatimi i ligjit për personat në këtë pjesë ku personat e verbër lirohen nga tatimi në pronë. MFTP ka mundësuar, dhe komunat kanë marrë për obligim zbatimin e saj. Në qoftë së ndonjë komunë nuk e zbaton këtë rekomandim, atëherë mund të përcillet kërkesa direkt në MFPT për të realizuar lirim nga tatimi në pronë.

Ndërsa, sa i përket komisionit shtetëror mediko social, i cili përcaktona shkallen e verbërisë sipas ligjit në Kosovë, kërkesa e kahershme e komuniteti të personave të verbër ka qenë ndryshimi i rregullores së punës. Gjatë këtij viti në takime me sekretarin e MFTP, është përcaktuar edhe grupi punues për plotësim ndryshimin e kësaj rregulloreje, me kërkesën kryesore që të eliminohet vlerësimin që momentalisht u bëhet çdo pesë vjet personave të verbër (kategoria e parë: person i verbër), pasi kjo është edhe e mundimshme për vetë ata dhe e panevojshme. Në këtë grup punues përfaqësues nga SHVK është kryetari Daut Tishuki.

Ristrukturimi i Shoqatës së të verbërve, kuvendet nëpër degë, risitë dhe ndryshimet

Bazuar në statutin e Shoqatës së të verbërve në Kosovë, SHVK gjatë vitit 2023 ka hyrë në proces zgjedhor të brendshëm. Procesi është zhvilluar nëpër komuna dhe përmbyllet me zgjedhjet në nivel nacional. Zgjedhjet komunale nëpër degë janë mbajtur gjatë periudhës Prill- Qershor 2023 dhe janë përcjellë me një debat nëpër degë, përzgjedhje të kandidatëve, dhe sipas dëshirës së anëtarësisë, me ndryshime të udhëheqësve lokale apo rizgjedhje në disa raste.

Në komunën e Pejës është rizgjedhur kryetar Mehmet Kastrati, në Ferizaj Daut Hoxha, në Gjakovë Mark Pjetraj, në Istog Besarta Gorqaj, Gjilan është rizgjedhur Bajram Spahija, Prishtinë Behxhet Gashi, Malishevë Isak Krasniqi dhe Rahovec Xhylferie Nazifi.

Siç shihet në disa shoqata komunale dhe ndërkomunale ka pasur ndryshime, që pritet të sjellin risi dhe angazhim më të madh në shoqatë.

Ndërsa në Mitrovicë ende nuk është mbajtur kuvendi zgjedhor, por në një takim të këshillit drejtues, të mbajtur në muajin qershor kryetari i deritashëm Skënder Kerolli ka dhënë dorëheqje. Zgjedhjet në shoqatë janë organizuar dhe monitoruar nga një komisioni i kryesuar nga Bekim Krasniqi, kryetar i komisionit, Rinor Ymeri ose Urim Kabashi dhe Melihate Pllana anëtarë të komisionit.

Komisioni ka vlerësuar të suksesshëm procesin zgjedhor si dhe efektin pozitiv që ka sjellë ai nëpër komuna. Në disa raste, si ai i Gjakovës është konsideruar se procesi zgjedhor ka rritur unitetin e anëtarësisë dhe ka tejkaluar disa nga problemet, duke sjellë një tjetër strukturë udhëheqëse në degë dhe duke i lënë hapësirë tejkalimit të ndasive dhe punës së përbashkët në të mirë të anëtarësisë.

Përpos kryetarëve nëpër kuvendet e komunave janë zgjedhur edhe strukturat tjera të degës dhe delegatët për zgjedhjet qendrore, që do mbahen në një datë që caktohet në vazhdim.

Komisioni i zgjedhjeve ka falënderuar të gjithë ata që janë angazhuar, ata që kanë sjellë me angazhimin e tyre shoqatën deri në gjendjen që është sot, dhe iu ka uruar mandatin e ri të zgjedhurve në degët e shoqatës.

Sporti dhe përfaqësimi i personave të verbër në aktivitetet vendore dhe ndërkombëtare

13 qershor 2023

Finalja e Shahut për të Verbër e Kosovës e organizuar nga Federata e Sporteve për të Verbër e Kosovës. Të pranishëm të gjithë finalistët.

5 qershor 2023

Pjesëmarrja e shahistëve të Verbër në Turnirin e Shahut për të Verbër “Izola 2023”.

Kosova përfaqësohet nga dy shahistë:

Xhafer Berisha dhe Shaip Kastrati.

Suksese shahistëve

19 prill 2023

Ekipi i Rezentacionit të Shahut për personat e verbër, në rrugë për në Kampionatin Evropian që mbahet në Genova të Italisë, si asnjëherë më parë i motivuar dhe kualitativ.

Kryetari i Federatës së Sporteve për të Verbër të Kosovës z. Rinor Ymeri, me datë 16 Mars 2023 në zyrën e zv. ministres znj. Daulina Osmani, pranoi Licencën për FSVK

12 shkurt 2023

Malmö Open - Ngjarja Evropiane e Parasportit është një pikë takimi madhështore ndërkombëtare. Pjesëmarrës nga jo më pak se 23 kombe të ndryshme do të mblidhen për të luftuar për medaljet

Ekipi i Kosovës u rendit në vendin e dytë në “Malmo Open 2023”

Mysafir të parë të mëngjesit ishin Rezentacioni i Kosovës në Goalball, i cili morri pjesë Turnirin ndërkombëtar “Malmo Open 2023”, në Malmo të Suedisë. Ekipi i Kosovës u rendit në vendin e dytë në “Malmo Open 2023” me medalje të argjend dhe golashënuesin më të mirë të Turneut, Shqipron Kuliqi me gjithsejtë 55 gola të shënuar në 6 ndeshje.

Pjesëmarrja është mundësuar nga: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit Ministrin